



A.nr. 2086/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2086/2025, të datës 29.12.2025, të parashtruar nga ankuesi M.K, nga Obiliqi, në çështjen juridike-administrative “*masës disiplinore-ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 05.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.2086/2025, e datës 29.12.2025, e parashtruar nga ankuesi M.K.
- II. Anullohet** Vendimi me Nr. 02-110-03-38757-25, i datës 16.12.2025, i Kryetarit të Komunës së Obiliqit.
- III. Obligohet** Kryetari i Komunës së Obiliqit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ndërmarr veprimet që ankuesin ta kthejë në vendin e punës sipas Akt Emërimit të datës 27.11.2025, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe duke bërë kompensimin e diferencës së pagës ndërmjet pagës klasës profesional 2 dhe pagës së kategorisë së ulët drejtuese, nga dita e nxjerrjes së vendimit për përfundimin e marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi M.K, (*tutje referuar ankuesi*), më datë 29.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 02-110-03-38757-25, të datës 16.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Obiliqit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 08.01.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Obiliqit, ndërsa, ky i fundit, më datë 16.01.2026, i ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës, duke dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8118/2025 të datës 29.12.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin me Nr. 02-110-03-38757-25, të datës 16.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Akt Emërimit të datës 27.11.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.01.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 16.01.2026; Vendim me Nr. 02-110-03-38931-25 të datës 29.12.2025 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, sepse:

Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave materiale rezulton:

- Ankues sipas Aktit të Emërimit me Nr.02-110-03-36487-25, të datës 27.11.2025, mban pozitën Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Obiliqit.
- Kryetari i Komunës së Obiliqit, më datë 26.12.2025, ka nxjerr Vendim me Nr. 02-110-03-38757-25, me të cilin sipas pikës 1. ankuesi është shkarkuar nga detyra e Udhëheqësit të Sektorit të Gjendjes Civile, sipas pikës 2. i përfundon marrëdhënia e punës si Udhëheqë i Sektorit dhe sipas pikës 3. është shfuqizuar Akt Emërimi me Nr. 02-110-03-3648725, i datës 27.11.2025.
- Kryetari i Komunës së Obiliqit, më datë 29.12.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-110-03-38931-25, me të cilin ankuesin e ka caktuar në vendin e punës Zyrtar i Gjendjes Civil në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

Pretendimet ankimore

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 02-110-03-38757-25, të datës 16.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, pretendon se vendimi i kontestuar nuk ka asnjë bazë ligjore dhe është nxjerr pa u respektuar asnjë procedurë e Ligjit për Zyrtarët Publikë, ngase shkarkimi nga puna nuk mund të bëhet në këtë mënyrë dhe nga Kryetari i Komunës, sepse nëse konstatohet se ka neglizhencës në punës duhet iniciuar procedurë disiplinore nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe vetëm Komisioni Disiplinor mund të merr një vendim të tillë. Kërkon të anulohet vendimi i kontestuar.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimet ankimore që kanë të bëjnë kundër Vendimit me Nr. 02-110-03-38757-25, të datës 16.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Obiliqit dhe gjithashtu ka shqyrtuar edhe ligjshmërinë e këtij vendimit, duke konstatuar se sipas provave materiale të çështjes, rezulton se ankuesi ka pasur akt emërim të vlefshëm për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile, ndërsa sipas vendimit të kontestuar përmes ankesës, respektivisht sipas pikë 1 është shkarkuar nga detyra e Udhëheqësit të Sektorit të Gjendjes Civile, sipas pikës 2. i përfundon marrëdhënia e punës si Udhëheqë i Sektorit dhe sipas pikës 3. është shfuqizuar Akt Emërimi me Nr. 02-110-03-3648725, i datës 27.11.2025, ndërsa sipas arsytimit të këtij vendimi konstatohet se ankuesi gjatë orarit të punës paraqet neglizhencës në punë, ndërsa në përgjigjen në ankesë të datës 16.01.2026, të dërguar nga Komuna e Obiliqit, Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, ka theksuar *se pretendimet e ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk qëndrojnë sepse në rastin konkret kemi pranuar disa ankesa verbane nga palët se kërkesat e tyre nuk po trajtohen nga ankues dhe ne disa here kemi dhënë vërejtje verbale siç parashihet me nenin 57 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë për arsye se i njëjti ka treguar neglizhencë gjatë orarit të punës, mos përmbushje të detyrave të punës, mos respektim i afateve të caktuara për përmbushje e detyrave të punës dhe sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil.*

Bazuar në arsyetimin e dhënë si në Vendimin me Nr. 02-110-03-38757-25, të datës 16.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, si dhe arsyetimin e dhënë nga Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Obiliqit, supozohet se ankuesi ka treguar neglizhencë gjatë orarit të punës, mos përmbushje të detyrave të punës, mos respektim i afateve të caktuara për përmbushje e detyrave të punës dhe sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil, e që sipas Kolegji të Këshillit, këto konsiderohen shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 56 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08.L197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet: “*Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhenca e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civilë; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e*

detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se me nenin 58 dhe 59 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë janë paraparë kompetencat për trajtimin e shkeljeve të rënda disiplinore dhe procedurën për fillimin e disiplinore, e këto procedura janë të paraparë edhe me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil. Përkitazi me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë, konstaton se Kryetari i Komunës nuk ka asnjë kompetencë ligjore që të bëjë shkarkimin e nëpunësit civil nga pozita të cilën e mban me akt emërim sepse ligji material nuk ka paraparë institutin e SHKARKIMIT nga detyra, po ashtu në rastin konkret të ankuesit nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për përfundimin e marrëdhënies së punës sepse duhet plotësuar kushtet e parapara me nenin 73 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që në rastin konkret të ankuesit nëse është supozuar që i njëjti nuk ka përmbushur detyrat e punës të vetmet veprimet që janë të ligjshme të ndërmerren është që rasti të trajtohet në procedurë disiplinore.

Në këtë kontekst Kolegji i Këshillit, në dritën e fakteve dhe dispozitave ligjore, vë në dukje se Vendimi me Nr. 02-110-03-38757-25, i datës 16.12.2025, i Kryetarit të Komunës së Obiliqit, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht: - Nenit 8 paragrafi 1, ku përcaktohet: *1. Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit.*

- Nenit 37 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: *1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj.*

Pra mbi këtë kuadër ligjor, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr. 02-110-03-38757-25, i datës 16.12.2025, i Kryetarit të Komunës së Obiliqit, është edhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht:

- Nenit 4 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: *1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj, pra në këtë rast Kryetari i Komunës së Obiliqit ligjërisht nuk ka pasur kompetente të nxjerr një akt të tillë sikurse ky i kontestuar me ankesë sepse veprimet e tilla nuk janë të autorizuara sipas ligjit material.*

- Nenit 47 paragrafi 1, ku përcaktohet: *1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin)....*

-Nenit 48 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: *1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e*

situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në konstatimet e dhëna si më lartë, duke marr parasysh dispozitat ligjore të aplikueshme e të elaboruara si më sipër, erdhi në përfundimin se Vendimi me Nr. 02-110-03-38757-25, i datës 16.12.2025, i Kryetarit të Komunës së Obiliqit, është tërësisht i paligjshëm dhe i njëjti i plotëson në mënyrë të plotë elementet e paligjshmërisë së aktit administrativ të përcaktuar me nenin 52 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-197 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit, kështu që si rezultat i paligjshmërisë së këtij vendimi, Kolegji i Këshillit vlerëson se i njëjti nuk mund të prodhojë pasoja juridike karshi marrëdhënies së punës së ankuesit, por përveç kësaj paligjshmërie, sipas provave materiale të çështjes, Kolegji, ka vërejtur se Vendimi me Nr. 02-110-03-38757-25, i datës 16.12.2025, i Kryetarit të Komunës së Obiliqit, është ekzekutuar pa u plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës, ngase Kryetari i Komunës së Obiliqit, më datë 29.12.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-110-03-38931-25, me të cilin ankuesi është caktuar në vendin e punës Zyrtar i Gjendjes Civil në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.**

Duke qenë se pretendimet ankimore të ankuesit janë të qëndrueshme dhe kanë mbështetje ligjore, ndërsa nuk mund të pranohen si të ligjshme pretendimet e organit të punësimit të dhëna përmes përgjigjes në ankesë, sepse përveç tjerash asnjë nga pretendimet nuk i ka mbështetur me prova materiale, kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht e aprovoj ankesën si të bazuar, duke e anuluar si të paligjshëm Vendimin me Nr. 02-110-03-38757-25, të datës 16.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, duke e obliguar Kryetarin e Komunës së Obiliqit, që të ndërmarr veprimet që ankuesin ta kthej në vendin e punës sipas Akt Emërimit të datës 27.11.2025, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe duke bërë kompensimin e diferencës së pagës ndërmjet pagës klasës profesional 2 dhe pagës së kategorisë së ulët drejtuese, nga dita e nxjerrjes së vendimit për përfundimin e marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.2086/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit M.K;
- Organit të punësimit: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.